
ANKETA MBI SISTEMIN E GJURMIMIT TË OFRUESVE TË TRAJNIMIT JOFORMAL NË KOSOVË

Prishtina, Kosovë

PËRMBAJTJA

1 HYRJE

2 QASJA METODOLOGJIKE

3 INFORMATA TË PËRGJITHSHME

4 PYETJET SPECIFIKE

5 KONKLuzionET

Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE), që implementohet nga Helvetas dhe MDA. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e UBO Consulting dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC-së.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

EYE

Enhancing Youth
Employment

TABELA E FIGURAVE

| | |
|--|---|
| Figura 1. Fusha e trajnimeve të ofruara (n=40)..... | 2 |
| Figura 2. Kapacitetet e zhvillimit të pakove të reja trajnuese (n=40) | 2 |
| Figura 3. Komunikimi me industrinë me qëllim të zhvillimit të pakove të reja trajnuese (n=40).. | 2 |
| Figura 4. Lloji i mbështetjes që kompanitë kanë nevojë për t'i zhvilluar paket e reja trajnuese (n=40)..... | 2 |
| Figura 5. Metodatat për kontrollimin e cilësisë së trajnimeve (n=40)..... | 2 |
| Figura 6. Përdorimi i sistemit të gjurmimit (n=40) | 2 |
| Figura 7. Arsyet për krijimin e sistemit të gjurmimit (n=18)..... | 2 |
| Figura 8. Metoda për gjurmimin e të trajnuarve (n=18) | 2 |
| Figura 9. Aplikimi i teknologjisë për gjurmimin e studentëve (n=32)..... | 2 |
| Figura 10. Kostoja e posedimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të gjurmimit (n=18) | 2 |
| Figura 11. Arsyet e mosposedimit të sistemit të gjurmimit (n=37)..... | 2 |
| Figura 12. Interesimi i kompanive që në të ardhmen të zhvillojnë aktivitete të orientimit në karrierë (n=40) | 2 |

HYRJJE

Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE), një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili implementohet nga konsorciumi i Helvetas Swiss Intercooperation (HSI) dhe Management Development Associates (MDA) ka për qëllim përmirësimin e tregut për ofruesit privat të trajnimit, gjë që kontribuon në zhvillimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre me shkathtësi të nevojshme, të kërkuara nga tregu i punës.

Qëllimi i përgjithshëm i EYE është të kontribuojë në një treg pune më dinamik dhe me përfshirje sociale, i cili ofron më shumë vende të përshtatshme pune, duke përfshirë vetëpunësimin për të rinjtë në Kosovë, që do të arrihet në mënyrë të qëndrueshme përmes intervenimeve sistematike.

EYE fokusohet në sistemin e tregut të punës, duke u orvatur që të zhvillojë shkathtësitë e fuqisë punëtore kosovare përmes përmirësimit të rrjedhës së informatave përkatëse në sistemin e tregut të punës, duke nxitur kështu rritjen e numrit të vendeve të punës në sektorin e TIK-ut, prodhimit dhe sektorët tjerë. Si rrjedhojë, projekti bashkëpunon me akterët midis ofertës dhe kërkesës për vende të kualifikuara të punës, duke përfshirë ministritë dhe zyrat e qeverisë, shoqatat e biznesit dhe kompanitë private.

Gjatë fazës së kaluar, EYE është përqendruar të punojë drejtpërdrejt me ofruesit e trajnimit në zhvillimin dhe plasimin në treg të pakove të reja trajnuese, që do të plotësojnë nevojat specifike të tregut të punës. Intervenimet dallonin ndërmjet industrive të ndryshme dhe atyre specifike, ndërsa partnerëve mbështetja iu ofrua në mënyra të ndryshme, duke pasur parasysh arritjen e qëndrueshmërisë së synuar dhe ndikimit maksimal në tregun e ofrimit të trajnimit.

Aktualisht, EYE gjendet në vitin e parë të fazës 3 dhe një ndër fushat që është e interesuar ta hulumtojë ka të bëjë me mënyrën se si ofruesit e trajnimit i zhvillojnë pakot trajnuese dhe në ç'mënyrë i gjurmojnë të diplomuarit e tyre. Përmes këtij hulumtimi EYE ka për qëllim ta kuptojë rëndësinë e kurrikulës dhe cilësinë e trajnimeve të ofruara, duke përfshirë kënaqshmërinë e të trajnuarve dhe punëdhënësve. Gjetjet nga ky hulumtim do të shfrytëzohen për të planifikuar aktivitetet e ardhshme të projektit EYE.

Duke marrë parasysh arsyet e lartpërmendura, gjatë periudhës prill - maj 2021, EYE ka kontraktuar agjencinë UBO Consulting për të kryer anketën mbi sistemin e gjurmimit të partnerëve të EYE. Përgjegjësitë kryesore të UBO Consulting kanë përfshirë:

- *Rishikimin dhe finalizimin e pyetësorit të anketës*
- *Përkthimin e pyetësorit në gjuhën shqipe*
- *Kodimin e pyetësorit në KoBoToolbox*
- *Grumbullimin e të dhënave*
- *Interpretimin e rezultateve dhe përpilimin e raportit*

QASJA METODOLOGJIKE

Anketa mbi sistemin e gjurmimit të partnerëve të EYE aplikoi metodën sasiore të hulumtimit. Për qëllimin e duhur të kësaj ankete, UBO Consulting zhvilloi 40 pyetësorë online me kompanitë që ofrojnë trajnime. Grumbullimi i të dhënave u realizua ndërmjet periudhës 10 - 17 maj, 2021.

EYE përgatiti listën fillestare të mostrave të përzgjedhura, të përbërë nga 45 kompani që ofrojnë shërbime të trajnimit. Për ta bërë të mundshme plotësimin e 40 pyetësorëve, lista u zgjerua më tej duke aplikuar **teknikën e përzgjedhjes së mostrave përmes metodës së topit të borës (snowball technique)** (ku subjektet ekzistuese ofrojnë referenca për të angazhuar kompani që nevojiten për studimin hulumtues). Tabela në vijim paraqet listën e ofruesve të trajnimit që plotësuan pyetësorin online:

| Nr. | Emri i kompanisë që ofron trajnime | Nr. | Emri i kompanisë që ofron trajnime |
|-----|---|-----|--|
| 1 | TC Shehu | 21 | VentureUP |
| 2 | NGO Local Initiative Link | 22 | Klasteri i Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës - KIMERK |
| 3 | Fondacioni BONEVET - Prishtinë | 23 | Cactus Education |
| 4 | Weld Tech Shpk | 24 | Kolegji European i Kosovës |
| 5 | Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë- APPK | 25 | Gračanica Innovation Centar |
| 6 | Qendra e Aftesimit Profesional - Prizren | 26 | IT&CAD Training Center |
| 7 | Beetroot Academy | 27 | PBC Academy SH.P.K. |
| 8 | RIT Kosovo (A.U.K) College | 28 | jCoders SH.P.K. |
| 9 | Shkolla Digjitale | 29 | SHPDK |
| 10 | Universum Digital Marketing Institute (franchise) | 30 | Korabi Corporation SH.P.K. |
| 11 | ProEd sh.p.k | 31 | Soinn academy |
| 12 | IPKO Foundation | 32 | SPEEEX EDUCATION SHPK |
| 13 | UNITED PIXELS | 33 | Creative Hub L.L.C |
| 14 | BIT Academy | 34 | Instituti profesional ATC sh.p.k. - Prishtinë |
| 15 | Jungle | 35 | NUKLEUS |
| 16 | Dekoriti SH.P.K. | 36 | PECB |
| 17 | Melita&Partners SH.P.K. | 37 | Business Consultant Council |
| 18 | EX-CITE | 38 | Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) |
| 19 | Fondacioni BONEVET - Kaçanik | 39 | Manaferra |
| 20 | Meister Training Center | 40 | BAFF Works SH.P.K. |

Vegëza e pyetësorit të anketës online iu dërgua përmes e-mailit të gjithë ofruesve të trajnimit në listën fillestare, si dhe atyre që u shtuan më pas nëpërmjet teknikës së përzgjedhjes së mostrave përmes metodës së topit të borës. Përveç kësaj, kompanitë u kontaktuan nëpërmjet telefonit, për t'iu rikujtuar plotësimin e pyetësorit të anketës.

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Anketa mbi sistemin e gjurmimit të partnerëve të EYE grumbulloi informacione të përgjithshme në lidhje me kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit. Para se gjithash, pyetësi përfshiu pyetjet që kishin të bënin me numrin e të punësuarve në kompani.

Bazuar në rezultatet, kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit (40 kompani) punësuan gjithsej 856 punëtorë, ndërsa numri mesatar arriti në 22. Shumica e këtyre të fundit (536 punëtorë) ishin punëtorë me orar të plotë, teksa 320 punëtorë tjerë ishin kontraktuar/punësuar me orar të shkurtuar të punës.

Përveç kësaj, kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit u pyetën për vendndodhjen e tyre të operimit. Sikurse edhe treguan rezultatet e anketës, shumica e këtyre kompanive ndodhen në kryeqytet - Prishtinë, ndërsa vetëm disa prej tyre ndodhen në qytetet tjera të Kosovës, si Lipjan, Mitrovicë, Kaçanik, Graçanicë, Vushtrri, etj. Duhet të ceket se një numër i konsiderueshëm i kompanive të intervistuar operonin në më shumë se një qytet.

Nga aspekti i vitit të themelimit, kompania më e vjetër ishte themeluar në vitin 1989, ndërsa ajo më e reja ishte themeluar këtë vit (2021).

Sa i përket fushës së trajnimeve të ofruara, më shumë se gjysma e kompanive (21) ishin të specializuara në trajnimet e informacionit dhe teknologjisë (IT). Kompanitë tjera ofrojnë trajnime për kuzhinën/gatimin (4), instalimet elektrike/sanitare (4), kontraktimet e procesimit të biznesit BPO (3), etj. Marketingu dhe dizajni, menaxhimi i biznesit, edukimi, inxhinieria, kontabiliteti dhe financat, përpunimi dhe prodhimi i drurit, dizajni dhe vizualizimi për interior, etj ., ishin fushat e tjera të trajnimeve të ofruara, që janë cekur nga pjesa tjetër e kompanive të intervistuar.



Figura 1. Fusha e trajnimeve të ofruara (n=40)

OFERTA E PAKOVE TRAJNUESE

Në këtë studim, kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit u pyetën rreth numrit të pakove trajnuese që ata i ofrojnë gjatë një viti. Brenda një viti, numri i gjithëmbarshtëm i pakove trajnuese të ofruara nga ofruesit joformal të trajnimit është 466, prej të cilave 252 llogariten si profile dhe 214 si module. Gjatë verifikimit të të dhënave doli në pah se ofruesit joformal të trajnimeve kanë mënyra të ndryshme të ofrimit të pakove trajnuese. Disa prej tyre raportuan numrin e profileve, teksa ofruesit tjerë raportuan numrin e moduleve si pjesë e profileve të ofruara. Detajet rreth numrit të profileve dhe moduleve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

| Kompania | Numri i profileve | Numri i moduleve | Kompania | Numri i profileve | Numri i moduleve |
|---|-------------------|------------------|-------------------------------------|-------------------|------------------|
| RIT Kosovo (A.U.K) College | 3 | 56 | Këshilli i Konsulentëve të Biznesit | 4 | - |
| Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë- APPK | 3 | - | Creative Hub L.L.C | 7 | - |
| Qendra e Aftësimi Profesional – Prizren | 12 | - | SPEEEX EDUCATION | 4 | - |
| VentureUP | 10 | - | Instituti profesional ATC | 11 | - |
| Klasteri i Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtërishme të Kosovës – KIMERK | 10 | - | Gračanica Innovation Center | 4 | - |
| IPKO Foundation | 4 | 18 | BAFF Works | 2 | - |
| NGO Local Initiative Link | 3 | 18 | EX-CITE | 4 | - |
| Shkolla Digjitale | 2 | 14 | Manaferra | 4 | - |
| jCoders | 20 | - | TC Shehu | 5 | - |
| Melita&Partners | 1 | 5 | Beetroot Academy | 6 | - |
| IT&CAD Training Center | 8 | - | PBC Academy | 3 | 19 |
| Universum Digital Marketing Institute (franchise) | 30 | - | Jungle | 5 | 24 |
| BIT Academy | 11 | - | Nukleus | 1 | 5 |
| Korabi Corporation | 4 | - | ProEd | 6 | - |
| Fondacioni BONEVET Kaçanik | 15 | - | Soinn academy | 6 | - |
| Fondacioni BONEVET Prishtinë | 3 | - | Meister Training Center | 3 | 30 |
| Cactus Education | 2 | 20 | Weld Tech | 5 | - |
| UNITED PIXELS | 6 | - | Dekoriti | 4 | - |
| SHPDK | 1 | 5 | Kolegji European i Kosovës | 10 | - |
| Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) | 10 | - | PECB | - | 300 |

¹ **Shënim:** Numri i moduleve të raportuara nga PECB nuk përfshihet në numrin e gjithëmbarshtëm për shkak të vështirësive për të siguruar informacione në lidhje me trajnimet e ofruara në Kosovë.



INVESTIMET NË SEKTOR

Përveç pyetjeve të përgjithshme, kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit iu shtruan edhe disa pyetje specifike në lidhje me numrin e studentëve të trajnuar, gjininë e tyre, investimet në qendrat e trajnimit, zhvillimin e pakove trajnuese, mbështetjen ndaj zhvillimit të pakove trajnuese, cilësinë e trajnimeve dhe sistemet e gjurmimit.

Që nga themelimi i tyre, kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit kanë arritur t'u ofrojnë trajnime afërsisht 90,000 studentëve, prej të cilëve 53,289 ishin studentë meshkuj dhe 35,840 ishin studente femra. Bazuar në këtë vlerësim, numri mesatar i studentëve meshkuj të trajnuar është 1,341, ndërsa ai i studenteve femra të trajnuara është 896.

26 nga 40 kompani që ofrojnë shërbime të trajnimit deklaruan shumën e investuar gjatë dy viteve të fundit në qendrat e tyre të trajnimit. Një numër i konsiderueshëm i këtyre kompanive (26) dukej se kishin bërë investime të mëdha gjatë kësaj periudhe kohore. Këto investime përfshinin investimet në aspektin teknik, kapacitete profesionale ose në hapësira/objekte. Në vlerë monetare, shuma e investimit sillet midis 10,000 dhe 1 milion euro.

KAPACITETET PËR TË ZHVILLUAR PAKO TË REJA TRAJNUESE

Për më tepër, gjysma e ofruesve të trajnimit (20) njoftuan se i shfrytëzojnë kapacitetet e tyre të brendshme për të zhvilluar pako të reja trajnuese, ndërsa vetëm shtatë (7) kompani i shfrytëzuan kapacitetet e kontraktuara nga jashtë. Nga ana tjetër, gjithsej 10 kompani aplikuan të dyja metodat (kapacitetet e brendshme dhe ato të kontraktuara nga jashtë) për të zhvilluar pako të reja trajnuese.



Figura 2. Kapacitetet e zhvillimit të pakove të reja trajnuese (n=40)

Rezultatet e anketës treguan gjithashtu se shumica e kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit (35) komunikojnë me industrinë (ofruesi i trajnimit në fushën përkatëse që operon, p.sh., shoqatat e biznesit, kllasterët, odat, etj.) me qëllim të zhvillimit të pakove të reja trajnuese.



Figura 3. Komunikimi me industrinë me qëllim të zhvillimit të pakove të reja trajnuese (n=40)

Megjithatë, këto kompani theksuan gjithashtu se kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme në aspektin e zhvillimit të pakove të reja trajnuese. Mbështetja financiare (38) u konsiderua si lloji më efektiv i mbështetjes për zhvillimin e pakove të reja trajnuese. Sidoqoftë, mbështetja/ekspertiza profesionale (24) dhe mbështetja teknike (18) u nënvizuan gjithashtu nga një numër i konsiderueshëm i kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit.




Figura 4. Lloji i mbështetjes që kompanitë kanë nevojë për t'i zhvilluar paket e reja trajnuese (n=40)

Pyetësi i anketës u përqëndrua edhe në cilësinë e trajnimeve dhe sistemin e gjurmimit. Sa i përket cilësisë së trajnimit, kompanitë u pyetën për metodat që aplikojnë për të kontrolluar cilësinë e trajnimeve që ofrojnë. Sikurse nënkuptohet nga rezultatet, anketat (30) dhe formularët e pyetësorëve/vlerësimit (24) ishin metodat më të aplikuara për të kontrolluar cilësinë e trajnimeve. Në këtë aspekt, grupet e fokusit (13) dhe informatat kthyes joformale nga të trajnuarit (7) u aplikuan më pak. Duhet të theksohet se disa nga kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit preferuan ta vlerësojnë cilësinë e trajnimeve duke u bazuar në vizitat tek të trajnuarit e tyre, performancën gjatë projekteve specifike, komunikimin me partnerët tjerë tek të cilët i referojnë të trajnuarit e tyre, etj.



Figura 5. Metodat për kontrollimin e cilësisë së trajnimeve (n=40)

PËRDORIMI I SISTEMIT TË GJURIMIT

Megjithatë, sa i përket sistemeve aktuale të gjurmimit, rezultatet treguan se më pak se gjysma e kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit (18) posedojnë një sistem të ngjashëm, krahasuar me pjesën tjetër të kompanive (22), të cilat akoma nuk kanë arritur ta krijojnë një sistem të tillë.




Figura 6. Përdorimi i sistemit të gjurmimit (N=40)

Kompanitë që tashmë posedonin një sistem të gjurmimit u pyetën për arsyet që kishin vendosur të krijonin atë sistem. Disa nga arsyet kryesore në këtë aspekt përfshinin: kënaqshmërinë/informatat kthyesë të të trajnuarve (15), zhvillimin e pakove të reja (14) dhe rëndësinë e kurrikulave (13). Për më tepër, ngritja e vetëdijes mbi brendin (11), investimet e mëtejshme (10) dhe kënaqshmëria e punëdhënësve (10) u konsideruan gjithashtu si faktorë të rëndësishëm që çojnë drejt krijimit të sistemit të gjurmimit.



Figura 7. Arsyet për krijimin e sistemit të gjurmimit (n=18) (numri i individëve që u janë përgjigjur kësaj pyetjeje)

Shumica e kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit theksuan se kanë gjurmuar të trajnuarit e tyre duke u bazuar në një regjistrim, i cili është zbatuar vetëm nga disa prej tyre që aplikojnë mostrat në këtë aspekt.



Figura 8. Metoda për gjurmimin e të trajnuarve (n=18)

TEKNOLOGJIA E PËRDORUR PËR GJURMIM

Sa i përket teknologjisë që këto kompani aplikojnë për t'f gjurmuar studentët e tyre, e-maili (15) dhe platforma e anketimit "survey monkey" (12) u nënvizuan si dy mjetet kryesore. Kur u pyetën rreth teknologjisë që aplikojnë për të gjurmuar studentët e tyre, pesë (5) kompani të tjera deklaruan se përdorin faqet në Facebook, vizitat në lokacion dhe aplikacionet tjera në internet.




Figura 9. Aplikimi i teknologjisë për gjurmimin e studentëve (n=32)

Kompanitë që ofrojnë shërbime të trajnimit u pyetën gjithashtu për vendimet/ndryshimet që marrin/bëjnë në bazë të rezultateve nga sistemi i gjurmimit. Në këtë kontekst, shumica e tyre deklaruan se rezultatet nga sistemi i gjurmimit kryesisht përdoren për përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga këto trajnime. Disa nga vendimet/ndryshimet specifike kishin të bënin me përmirësimin e kurrikulave të tyre, hartimin e pakove trajnuese, adresimin e investimeve të tyre të ardhshme, aplikimin e teknikave të reja, etj.

Së fundi, kompanitë u pyetën për koston e posedimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të gjurmimit. Siç treguan edhe rezultatet e anketës, shumica e kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit (14) e konsideronin këtë sistem si të shtrenjtë/deri diku të shtrenjtë, në krahasim me kompanitë tjera (4), të cilat supozonin se posedimi dhe mirëmbajtja e sistemit të gjurmimit nuk është e shtrenjtë/aspak e shtrenjtë.




Figura 10. Kostoja e posedimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të gjurmimit (n=18)

ARSYET E MOS POSEDIMIT TË SISTEMIT TË GJURMIMIT

Ofruesit e trajnimit të cilët nuk e posedonin sistemin e gjurmimit u pyetën rreth arsyeve për këtë vendim. Bazuar në rezultatet e anketës, kostoja e lartë e këtij sistemi (11) dhe mungesa e kapaciteteve profesionale ishin dy arsyet kryesore që kompanitë të cilat ofrojnë shërbime të trajnimit nuk posedonin një sistem të gjurmimit. Sidoqoftë, disa kompani e konsideruan këtë sistem si të panevojshëm (7) ose kohë-harxhuese (6).



Figura 11. Arsyet e mosposedimit të sistemit të gjurmimit (n=37)

Dy pyetjet e fundit të kësaj ankete vlerësuuan gatishmërinë e ofruesve të trajnimit për të investuar në implementimin e sistemit të gjurmimit, si dhe interesimin e tyre që në të ardhmen të zhvillojnë aktivitete të orientimit në karrierë. Përderisa shumica e këtyre kompanive nuk ofruan ndonjë shumë të saktë të parave për të investuar në sistemin e gjurmimit, shumica prej tyre theksuan se ishin të gatshëm që ta marrin në konsideratë këtë ide dhe të punonin në këtë drejtim. Nga ana tjetër, shumica e kompanive që ofrojnë shërbime të trajnimit treguan interesim që në të ardhmen të zhvillojnë aktivitete të orientimit në karrierë.




Figura 12. Interesimi i kompanive që në të ardhmen të zhvillojnë aktivitete të orientimit në karrierë (n=40)

KONKLuzionet


Anketimi mbi sistemin e gjurmimit të partnerëve të EYE u zhvillua për të kuptuar rëndësinë e kurrikulave dhe cilësinë e trajnimeve të ofruara, duke përfshirë kënaqshmërinë e të trajnuarve dhe punëdhënësve. Për qëllimin e duhur të kësaj ankete, u menaxhuan gjithsej 40 pyetësorë online, me gjithsej 40 kompani që ofrojnë shërbime të trajnimit.

Duke marrë parasysh të dhënat e grumbulluara nga anketa, këto kompani punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve, teksa shumica e punëtorëve pajisen me kontratë pune me orar të plotë. Përderisa shumica e kompanive ndodhen në Prishtinë, një numër i konsiderueshëm i ofruesve të trajnimit operojnë edhe në qytetet tjera. Këta të fundit janë të specializuar kryesisht në TI, kuzhinë/gatim, instalime elektrike/sanitare, kontraktimet e procesimit të biznesit (BPO), marketing, edukim, menaxhim të biznesit, etj.

Për më tepër, kompanitë e trajnimit kanë arritur t'u ofrojnë trajnime një numri shumë të madh të studentëve, që nga themelimi i tyre. Ndërsa, gjatë dy viteve të fundit, investimet e tyre sa i përket aspekteve teknike, kapaciteteve profesionale ose hapësirave/objekteve të qendrave të tyre trajnuese ishin gjithashtu dukshëm të larta. Sa i përket zhvillimit të pakove të reja trajnuese, ofruesit e trajnimit shfrytëzuan kryesisht kapacitetet e brendshme. Pavarësisht komunikimit të tyre të qëndrueshëm me industrinë për zhvillimin e pakove të reja trajnuese, duket se edhe këto kompani kanë nevojë për mbështetje financiare, për të qenë kompetent në zhvillimin e pakove të reja trajnuese.

Rezultatet e anketës tregojnë se ofruesit e trajnimit nuk e konsiderojnë posedimin e sistemin të gjurmimit si një nga prioritetet; më pak se gjysma e kompanive të anketuara kanë aplikuar një sistem të tillë. Kompanitë kanë krijuar sistemin e tyre të gjurmimit për të qenë në gjendje të sigurojnë informata kthyesë nga të trajnuarit e tyre, të zhvillojnë pako të reja trajnuese, të hartojnë kurrikula të reja ose të administrojnë investimet e tyre. Përderisa shumica e kompanive gjurmojnë të trajnuarit e tyre bazuar në një regjistrim, për ta realizuar këtë, ato kryesisht përdorin e-mailin. Përveç kësaj, ato gjithashtu e konsiderojnë këtë sistem si deri diku të shtrenjtë. Krahas kompanive tjera, kostoja e lartë u identifikua gjithashtu si arsyeja kryesore për mosimplementimin e sistemit të gjurmimit.

Për shkak të kostove të larta të sistemit të gjurmimit, shumica e ofruesve të trajnimit shfaqin më pak gatishmëri për të investuar në këtë sistem. Sidoqoftë, pothuajse të gjithë ata janë të interesuar që në të ardhmen të zhvillojnë aktivitete të orientimit në karrierë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



HELVETAS
KOSOVO

Management
Development
Associates

MDA